



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 452 Prot.

Tiranë, më 18 . 03 . 2024

V E N D I M

Nr. 68, Datë 18 . 03 . 2024

Bazuar në pikën 11¹, të nenit 33, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O N :

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja “a”, dhe pika 3 e këtij neni, si dhe nenit 33 e 33/1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka ndjekur të gjithë hapat që parashikon procedura e hetimit administrativ, për shqyrtimin e ankesës nr. 135 Regj., datë 12.09.2022, paraqitur nga Fondacioni “Së Bashku”, kundër Bashkisë së Tiranës, me pretendimin për diskriminim të personave me aftësi të kufizuar për mosgarantimin e aksesueshmërisë në ishullin e kalimit në kryqëzimin e ri në rrugën “Dritan Hoxha”, pranë të ashtëquajturës “Kupola”, Bashkia Tiranë.

1. Bazuar në nenin 33/10, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në përfundim të procedurës së hetimit administrativ, Komisioneri ka dalë me Vendimin nr. 31, datë 27.02.2023, me anë të të cilit ka vendosur:

“1. Konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuar nga ana e Bashkisë së Tiranës, për shkak të mungesës së aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, në ishullin e

¹ “Nëse Komisioneri urdhëron rregullime ose masa, personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 ditëve para Komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit. Në rast se personi, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon Komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, Komisioneri vendos masë për ndëshkimin me gjobë për personin kundër të cilit është paraqitur ankesa. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni”.

² Në vijim do t'i referohemi si Komisioneri ose me akronimin KMD.

semaforin e kalimit të këmbësorëve në kryqëzimin e rrugës “Dritan Hoxha”, pranë të ashtëquajturës “Kupola”, Bashkia Tiranë.”

2. Në pikën 2, të këtij vendimi, Komisioneri ka vendosur:

“2. Bashkia e Tiranës, të marrë masa konkrete për të siguruar në mënyrë efektive, aksesueshmërinë në ishullin e kalimit të këmbësorëve në kryqëzimin e rrugës “Dritan Hoxha”, pranë të ashtëquajturës “Kupola”, Bashkia Tiranë, në përputhje me stadardet ligjore në fuqi dhe për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuar.”

Rezulton e provuar nga lajmërim marrja e shërbimit postar se, Bashkia e Tiranës ka marrë dijeni për vendimin sipërcituar.

Në nenin 33/11, të ligjit nr. 10221/2010 *“Per Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet se: *“Nëse Komisioneri urdhëron rregullime ose masa, personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 ditëve para Komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit. Në rast se personi, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon Komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, Komisioneri vendos masë për ndëshkimin me gjobë për personin kundër të cilit është paraqitur ankesa. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni”.*

Për sa më sipër, nëpërmjet shkresës me nr. 321 prot., datë 20.02.2024, Komisioneri i është drejtuar sërish Bashkisë së Tiranës, duke i sjellë në vëmendje, se brenda dhjetë ditëve nga marrja dijeni e kësaj shkrese, ka detyrimin të zbatojë Vendimin nr. 31, datë 27.02.2023, të KMD-së, si dhe i ka kërkuar të informojë KMD, lidhur me masat konkrete të marra për zbatimin e këtij vendimi.

Pavarësisht marrjes dijeni për sa më sipër, Komisionerit nuk i është dërguar asnjë përgjigje shkresore lidhur me masat që Bashkia e Tiranës duhet të ndërmerre për zbatimin e vendimit të mësipërm të KMD-së.

Komisioneri çmon se, Bashkia e Tiranës, si subjekt i cili është gjetur përgjegjës për sjelljen diskriminuese, jo vetëm që nuk e ka informuar Komisionerin brenda afateve ligjore të parashikuara nga neni 33, pika 11, të LMD, por nuk rezulton të ketë marrë masa konkrete për të zbatuar vendimin e Komisionerit.

Në këtë mënyrë, Bashkia, nuk ka përmbushur detyrimin ligjor të parashikuar nga neni 32, pika 11, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

Ky mosveprim, kjo mospërmbushje e këtij detyrimi ligjor, në bazë të nenit 33, pika 13, të ligjit të sipërpërmendur shoqërohet me marrjen e masave administrative, gjobë. Për personat juridik, siç është në rastin konkret Bashkia e Tiranës, ky nen përcakton shkrehimisht: *“Çdo person që shkel dispozitat e këtij ligji dënohet me gjobë si më poshtë”:*..... b) *personi juridik nga 60.000 deri në 600.000 lekë;.....”*

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi arrin në konkluzionin se, Bashkia e Tiranës, është në shkelje të detyrimit ligjor të përcaktuar në nenin 33, pika 11, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, shkelje e cila sipas nenit 33, pika 13, të po këtij ligji, është e dënueshme me gjobë.

Në lidhje me masën e gjobës, Komisioneri mban në konsideratë parashikimet dhe kriteret e vendosura në nenin 33, pika 12, të LMD, ku sanksionohet se: “12. Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës. Nëse vendoset gjobë, Komisioneri përcakton shumën e gjobës duke marrë parasysh: i) natyrën dhe fushën e veprimit të shkeljes dhe ndikimin mbi viktimën; dhe ii) rrethanat personale e financiare të shkelësit, veçanërisht duke marrë në konsideratë të gjitha burimet e të ardhurave dhe nëse shkelja kryhet nga një person juridik privat, merren parasysh aktivet e bilancit dhe fitimi, si dhe pagat totale të paguara punonjësve; c) nëse e njëjta shkelje diskriminon disa persona, vendoset vetëm një gjobë, por duke marrë parasysh kërkesat e shkronjës “b” të këtij neni.”

Duke mbajtur në konsideratë kriteret e mësipërme për përcaktimin e masës së gjobës, si dhe bazuar në faktin që:

- shkelja e konstatuar prek personat me aftësi të kufizuar që janë një grup shoqëror vulnerabël;
- shkelja e konstatuar ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve që paraqesin rëndësi të veçantë për personat me aftësi të kufizuar siç është garantimi i aksesueshmërisë në rrugë, sipas standardeve të miratuara në aktet përkatëse ligjore dhe nënligjore;

Komisioneri, arrin në përfundimin se, Bashkia e Tiranës, duhet të gjobitet me 200 000 (dyqind mijë) lekë, për moszbatimin e Vendimit nr. 31, datë 27.02.2023.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 32/1, shkronja “ç”, neni 33, pikat 11, 12, 13/a dhe 14, si dhe nenin 33/1, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Subjekti Bashkia e Tiranës, të gjobitet në vlerën 200.000 (dyqind mijë) lekë.
2. Gjoha të ekzekutohet dhe të derdhet në Buxhetin e Shtetit jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, vendimi i dhënë shndërrohet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit, me kërkesë të Komisionerit.

3. Paga e vlerës së gjobës të bëhet pranë çdo banke në llogarinë e thesarit Tiranë, për llogari të: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, NIPT: L02027451K, Kodi: 1091001, Entiteti i Qeverisjes: 1, Distrikti (TDO), Llogaria ekonomike: 7115499.
4. Zbatimi i Vendimit nr. 31, datë 27.02.2023, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, brenda shtatë ditëve nga marrja dijani për sanksionet, sjell shfuqizimin e tij.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në gjykatë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurave Administrative, të ndryshuar.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Punoi: R. Hoxha
Pranoi: V. Bushati
Datë: 18.03.2024